

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7978
E martë, 28 janar 2025
Çmimi 0.50 €

Kosova bën platformë për mbrojtje nga sulmet kibernetike



FACE 5

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYSMA E PARË E FUSHATËS ME SHUMË AKTIVITETE, POR ME GJUHË NXITËSE DHE TË URREJTJES NGA PARTITË POLITIKE

FACE 4



Gjatë dy javëve të para janë mbajtur 377 tubime publike të subjekteve politike, 160 në javën e parë, ndërsa 217 aktivitete të tjera në javën e

dytë, në të gjitha komunat e vendit, duke përfshirë edhe ato me shumicë serbe. Me numrin më të madh të aktiviteteve po vazhdon të

prijë LDK-ja me 109 aktivitete, ndjekur nga PDK-ja me 106 aktivitete, LV-ja me 71 aktivitete, si dhe AAK-ja me 54 aktivitete

SKANDALOZE: REKRUTËT E RINJ TË FSK-SË USHTROJNË ME ATLETE, NUK KANË MBATHJE USHTARAKE

F.5



LAJÇAKU NË JAVËN E FUNDIT SI EMISAR: DIALOGU ËSHTË MË VENDIMTAR SE KURRË NË BOTËN E SOTME

F.3



OPINION

PARTIA NË PUSHTET, SI PARA 4 VITESH: SHUMË PRETME DEKORATIVE (STERILE) PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË 9 SHKURTIT F.6

Shkruan: Prof. dr. Fejzulla BERISHA




AKTUALE



SORENSENI KONFIRMUOHET EMISAR PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI F.3

IPK-JA: VETURA E POLICISË NUK IU PËRSHTAT SHPEJTËSISË DHE GODITI VETURËN CIVILE NË SKENDERAJ, HUMBËN JETËN TRE QYTETARË F.7

EKONOMI



EKONOMIA E KOSOVËS: SHUMË PRETME, PAK PËRPARIME F.8

SPORT



NUHIU EMËROHET NDIHMËSTRAJNER NË PËRFAQËSUESËN A F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mijëra palestinezë nisin të kthehen në veri të Gazës

PRISHTINË, 27 JANAR - Dhjetëra mijëra palestinezë janë nisur të hënën në rrugën kryesore që çon në veri të Gazës, pasi Hamasit është pajtuar t'i dorëzojë tri pengje izraelite këtë javë, dhe pasi forcat ushtarake izraelite kanë nisur të tërhiqen prej korridorit kryesor të enklavës. Hamasit, grup palestinez që udhëheq Gazën, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Një turmë e madhe njerëzish, disa duke mbajtur foshnja apo gjësende të domosdoshme nëpër duar, janë nisur në këmbë drejt veriut të Gazës. "Më duket sikur të kem lindur sërish dhe të jemi fitimtarë sërish", ka thënë një nënë palestineze për agjencinë e lajmeve "Reuters". Dëshmitarët kanë thënë se banorët e parë kanë mbërritur në qytetin e Gazës herët në mëngjes. Më vonë janë hapur edhe tri

pikëkalime të tjera, duke mundësuar edhe qarkullimin e makinave. "Zemra po më rrah fort. Kam menduar që nuk do të kthehem më kurrë", ka thënë Osama, 50 vjeç, shërbyes publik dhe baba i pesë fëmijëve, teksa ka arritur në qytetin e Gazës. "Pavarësisht se a do të ketë sukses armëpushimi, ne nuk do të largohemi më kurrë nga qyteti i Gazës dhe veriut, edhe nëse Izraeli sjell tanke për secilin prej nesh, nuk do të ketë më zhvendosje". Duke pasur parasysh faktin se banorët e Gazës janë shpërngulur disa herë përgjatë 15 muajve të luftës, turma njerëzish janë larguar me gëzim prej tendave dhe kampeve kur kanë marrë vesh lajmin që pikëkalimet do të hapen. "Nuk kam fjetur, i kam bërë gati të gjitha gjërat për t'u nisur qysh në agim", ka thënë Ghada, nënë e pesë fëmijëve. "Të paktën jemi duke shkuar në shtëpi, tani mund të them



se lufta ka përfunduar dhe shpresoj të jetë gjithçka qetë", ka thënë ajo për "Reuters". Sipas marrëveshjes për armëpushim, banorët e veriut të Gazës do të duhej të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre në fundjavë. Mirëpo Izraeli ka thënë se Hamasit e ka prishur marrëveshjen, meqë nuk e ka liruar gruan e marrë peng, Arbel Yehud. Të dielën vonë

ndërmjetësuesit e Katarit e kanë zgjidhur këtë mosmarrëveshje, dhe Hamasit është pajtuar që ta lirojë Yehudin bashkë me ushtaren Agam Berger, dhe një peng tjetër të enjten, dy ditë para lirim të tri pengjeve të tjera. Izraeli më pas e ka dhënë dritën e gjelbër që banorët e veriut të Gazës të mund të kthehen në vendbanimet e tyre prej të hënës.

Rreth 650 000 njerëz janë zhvendosur nga veriu i Gazës përgjatë luftës, e cila është nxitur nga sulmet e Hamasit në jug të Izraelit, më 7 tetor 2023, duke vrarë 1 200 njerëz dhe duke marrë peng mbi 240 të tjerë.

Më shumë se 47 000 palestinezë janë vrarë në sulmet izraelite në Gazë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze.

Një pjesë e mirë e Gazës është shkatërruar nga luftimet dhe autoritetet nën dirigjim të Hamasit kanë thënë se banorët e kthyer në veri të Gazës do të kenë nevojë për mijëra tenda dhe qendra strehimi, teksa tentojnë t'i rikthehen normalitetit. Sipas marrëveshjes së armëpushimit, vetëm personat e paarmatosur do të mund të kthehen në zonën veriore. Makinat do të kontrollohen në hollësi nëse kanë ndonjë armë apo lëndë shpërthyes.

Udhëheqësit mblidhen për ta shënuar 80-vjetorin e çlirimit të Aushvicit

BERLIN, 27 JANAR - Më 27 janar shënohet 80-vjetori i çlirimit të kampit famëkeq nazist të Aushvicit.

Udhëheqësit evropianë kanë shprehur shqetësim për rritjen e partive të ekstremit të djathtë, veçmas në Gjermani, shtet që do t'i mbajë zgjedhjet muajin e ardhshëm.

Shumë nga të mbijetuarit, që tani janë në moshë të shtyrë, mbanin shall me vija blu dhe të bardha, për t'i kujtuar uniformat e kampit dhe mbanin qirinj në duar teksa shkuan në Murin e Vdekjes në kampin në Poloni ku afër 1.1 milion persona u vranë nga pushtuesit nazistë.

Kampi u çlirua nga trupat sovjetike më 27 janar 1945, vetëm disa muaj para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. "Ne polakët, në këto toka - atëbotë të pushtuara nga nazistët gjermanë - gjermanët ndërjuan këtë industri të shfarosjes dhe këtë kamp përqendrimi, jemi ruajtësit e kujtimeve", tha presidenti polak Andrzej Duda, i cili shoqëroi të mbijetuarit në



ecjen drejt Murit të Vdekjes. Ceremonitë kanë nisur më herët gjatë ditës, ndërkaq në orën 16:00 ceremonia kryesore, në një tendë të veçantë të vendosur te hyrja e ish-kampit famëkeq. Një nga simbolet e ceremonisë ishte një vagon që qëndronte pranë portës.

Në ceremonitë në Poloni morën pjesë presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier, kancelari Olaf Scholz, udhëheqës të tjerë përfshirë edhe presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryediplomatën Donika Gërvalla. Scholz, i cili është në mes të një

fushate të vështirë për rizgjedhje, ka përjetuar rritjen e partisë antiumigrante, Alternativa për Gjermaninë (AfD), gjatë dhe para mandatit të tij si kancelar. "Kurrë nuk do t'i harrojmë. As sot, as nesër", tha Scholz, duke kujtuar më shumë se 1 milion të vrarë në Aushvic nga gjermanët.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, po ashtu, ka arritur në Poloni, pasi kishte ndezur qirinj në memorialin për Holokaustin, Babin Jar në Kiev, ku më shumë se 30 000 hebrenj u masakruan nga nazistët gjatë dy ditëve më 1941. "Ishte përpjekje e qëllimshme e nazistëve për të zhdukur një komb të tërë - për t'ia vrarë të gjithë njerëzit dhe për të shkatërruar që ia kujtonte botës popullin hebre", shkroi ai në X.

"Krimet e Holokaustit nuk duhet të përsëriten kur. Por, fatkeqësisht, kujtimi gradualisht po venitet dhe ligësia po tenton ta shkatërrojë jetën e kombeve të tëra që ende ekzistojnë në botë sot". Asnjë nga udhëheqësit e huaj

që morën pjesë në ceremoni nuk mbajti fjalim, sipas organizatorëve. Organizatorët duan që fokusi të mbetet te të mbijetuarit.

Ky përvjetor, po ashtu, shënon Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit. Në vigjilje të ceremonive përkujtimore në Poloni, një agjenci qeveritare izraelite që merret me mbështetjen e të mbijetuarve të Holokaustit lëshoi raportin vjetor, ku vlerësoi se më shumë se 123 000 të mbijetuar të Holokaustit aktualisht jetojnë në Izrael.

Në mesin e tyre përfshihen 41 751 persona që i mbijetuan përndjekjes naziste dhe 44 334 që u larguan pas avancimit të forcave naziste, veçmas në ish-Bashkimin Sovjetik. Grupi i tretë i 37 630 të mbijetuarve ishin viktimat të antisemitizmit gjatë luftës jashtë Evropës - kryesisht në Marok dhe Algjeri, por aty përfshihen edhe hebrenj iranianë.

Në raport përmenden 133 izraelitë që kishin luftuar gjatë Luftës së Dytë Botërore në radhët e forcave aleate.

Shefi i NATO-s bën thirrje për rritjen e shpenzimeve për mbrojtjen

Bruksel, 27 janar - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, u bëri thirrje vendeve anëtare të NATO-s t'i rrisin shpenzimet e tyre të mbrojtjes mbi 2 % të PBB-së së tyre, një shifër e vendosur një dekadë më parë që tani shihet nga disa si shumë e

ulët për shkak të sfidave të paraqitura nga Rusia. Rutte zhvilloi një takim me presidentin portugez Luis Montenegro në Lisbonë, i cili përsëriti angazhimin e Portugalisë për ta përmbyshur objektivin prej 2 % deri në vitin 2029. Në vitin

2023 Portugalia shpenzoi 1.5 % të PBB-së së saj për mbrojtje. "Ne e dimë se objektivi prej 2 %, i cili është vendosur për një dekadë, nuk do të jetë i mjaftueshëm për t'i përballuar sfidat e së nesërme. Për ta mbajtur NATO-n të fortë, ne duhet të

vazhdojmë të përshtatemi dhe që ta garantojmë sigurinë tonë në të ardhmen, ne duhet t'i shtojmë përpjekjet tona sot. Kjo do të thotë që ne duhet të shpenzojmë më shumë për mbrojtjen tonë", theksoi Rutte.



FSK-ja, pjesë e një ushtrimi të organizuar nga NATO

PRISHTINË, 27 JANAR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) me një ekip të Kibernetikës ka marrë pjesë në ushtrimin "Cyber Unity 25", ku ka treguar aftësi të jashtëzakonshme dhe lidhshmëri të nivelit të lartë gjatë pjesëmarrjes në ushtrimin shumëkombësh "Cyber Unity 25", i organizuar nga NATO.

Ky aktivitet kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe përgatitjes kundër kërcënimeve të avancuara kibernetike si dhe

shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e kapaciteteve ndërkombëtare.

Ekipi Kibernetik i FSK-së ka shfaqur aftësi në aspektin teknik, ashtu edhe në atë strategjik. Në pjesën teknike demonstroi aftësi të larta në identifikimin dhe menaxhimin e incidenteve komplekse kibernetike, duke vendosur standarde të larta të punës ekipore dhe ekspertizës teknike. Ndërkaq, në nivelin strategjik, ekipi tregoi lidhshmëri dhe aftësi të

shkëlqyera menaxheriale në skenarë të krizave kibernetike, duke marrë vendime të duhura nën presion dhe duke siguruar koordinimin efektiv mes veprimeve taktike dhe objektivave strategjike.

Ky ushtrim ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër kërcënimeve kibernetike, dhe Ekipi Kibernetik i FSK-së ka përfaqësuar Kosovën me profesionalizëm, përkushtim dhe dinjitet të lartë.



Përformanca e tyre në këtë aktivitet jo vetëm që pasqyron përgatitjen dhe përkushtimin e Forcës së

Sigurisë së Kosovës, por edhe forcon pozicionin e Kosovës si një kontribuuese aktive në sigurinë globale kibernetike.

Sorenseni konfirmohet emisar për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 27 JANAR - Peter Sorensen ka marrë pëlqimin përfundimtar nga ministrat e Jashtëm të Bashkimit Evropian për postin e përfaqësuesit të posaçëm të bllokut për dialogun për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Paraprakisht, më 24 janar ambasadorët e BE-së kishin konfirmuar Sorensenin në këtë post.

Politikani nga Danimarka u zgjodh nga përfaqësuesja e lartë e BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Kaja Kallas, për ta zëvendësuar Miroslav Lajçakun në këtë post. Pasi ka marrë pëlqimin nga ambasadorët dhe kryediplomatët, Sorenseni do ta nisë mandatin më 1 shkurt.

Emisarit aktual, Lajçak, i skadon mandati më 31 janar. Para nisjes së takimit në Bruksel të kryediplomatëve, ku Sorenseni u konfirmua, ministrja e Jashtëm e Sllovenisë, Tanja Fajon, tha se me zgjedhjen emisar të diplomatit nga Danimarka, po dërgohet mesazhi se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë mbetet lart në agjendën e bllokut evropian.

Kush është Sorenseni?

Sorenseni ka përvojë të gjatë diplomatike në strukturat e BE-së. Ai aktualisht është këshilltar i lartë në Shërbimin e Veprimit të jashtëm të BE-së (EEAS) për diplomaci digjitale. Gjatë



karrierës së tij diplomatike në BE, Sorenseni ka ushtruar disa detyra në Ballkanin Perëndimor. Ka shërbyer përfaqësues i posaçëm i BE-së për Bosnjë-Hercegovinë dhe shërbim i Zyrës së BE-së në

Sarajevë. Po ashtu, ka qenë shërbim i delegacionit të bllokut evropian në Shkup. Më herët Sorenseni ka punuar këshilltar edhe në Kosovë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK),

ndërsa ka qenë edhe përfaqësues i posaçëm i BE-së në Serbi. Në Ballkan ai ka punuar edhe në misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në

Evropë (OSBE) në Kroaci.

Përvoja e tij nga rajoni thuhet se ka qenë edhe një prej argumenteve se pse Kaja Kallas ka vendosur që ai të jetë pasardhësi i Lajçakut.

Për postin e lehtësuesit të dialogut garoi edhe ish-ministri i Jashtëm i Finlandës, Pekka Haavisto, i cili ka njohuri për zhvillimet në Ballkanin Perëndimor.

Për këto rol ishte përmendur edhe emri i ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Sllovenisë, Borut Pahor. Vitin e kaluar ai pranoi se ishte i interesuar për këtë post. Por, gjatë janarit të këtij viti tha se nuk do të garonte për këtë post, pasi ka kuptuar se kërkohet më shumë një nivel diplomatik sesa politik.

Gjatë mandatit gati pesëvjeçar të Lajçakut, Kosova dhe Serbia kanë arritur Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të raporteve.

Marrëveshja, e cila nuk është nënshkruar, është ligjrisht e obligueshme për palët, ka thënë blloku. BE-ja i ka akuzuar Kosovën dhe Serbinë për mosnisen e zbatimit të paktit, duke thënë se kjo do të ndikojë në rrugëtimin e dy shteteve drejt integriteteve evropiane. Dialogu për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, ka nisur më 2011. Gjatë procesit janë arritur disa marrëveshje, por pak prej tyre janë zbatuar në terren.


Lajçaku në javën e fundit si emisar: Dialogu është më vendimtar se kurrë në botën e sotme

PRISHTINË, 27 JANAR - Emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka treguar se kjo është java e fundit e tij në këtë post. Në "Facebook", ku ai ka treguar për takimet në Davos, ka bërë me dije se dialogu është më vendimtar se kurrë në botën e sotme. Ndër të tjera, emisari theksoi se BE-ja është serioze për zgjerimin e Bashkimit. "Këtë javë në Forumin Ekonomik Botëror

në Davos pata mundësinë të angazhohem me liderë, kolegë dhe miq për disa nga çështjet më urgjente të kohës sonë, duke përfshirë stabilitetin gjeopolitik dhe zhvillimin ekonomik. Pas një jave diskutimesh stimuluese, është e qartë se dialogu është më vendimtar se kurrë në botën e sotme. U takova, gjithashtu, me liderë nga Ballkani dhe mora pjesë në dialogun tradicional të

diplomacisë për rajonin. Në ndërhyrjen time theksova se BE-ja është serioze për zgjerimin e Bashkimit, por kjo nuk do të ndodhë si parazgjedhje dhe i kërkova rajonit të qëndrojë në kurs. Ndërsa filloj javën e fundit të gati pesë viteve të mia në rolin tim aktual, ditët në vijim do të fokusohem në informimet përfundimtare dhe procedurat e dorëzimit", ka shkruar Lajçaku.





Gjysma e parë e fushatës me shumë aktivitete, por me gjuhë nxitëse dhe të urrejtjes nga partitë politike

Gjatë dy javëve të para janë mbajtur 377 tubime publike të subjekteve politike, 160 në javën e parë, ndërsa 217 aktivitete të tjera në javën e dytë, në të gjitha komunat e vendit, duke përfshirë edhe ato me shumicë serbe. Me numrin më të madh të aktiviteteve po vazhdon të prijë LDK-ja me 109 aktivitete, ndjekur nga PDK-ja me 106 aktivitete, LV-ja me 71 aktivitete, si dhe AAK-ja me 54 aktivitete

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 JANAR - Koalicioni i OJQ-ve Demokracia në Veprim (DnV) ka mbajtur konferencën e dytë për medie lidhur me mbarëvajtjen e dy javëve të fushatës zgjedhore, mbulimin medial, gjuhën e urrejtjes dhe shpenzimet në rrjetet sociale. Sipas DnV-së, subjektet politike kanë vazhduar me intensitet të shtuar të aktiviteteve, në një ambient kryesisht të qetë, ndonëse shqetësues mbetet vazhdimi i përdorimit të gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes në aktivitetet e mbajtura nga subjektet politike. Një nga zhvillimet kryesore të javës së dytë të fushatës për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit është vendimi i Qeverisë së Serbisë për të shpërndarë, nga data 1 shkurt, 20 mijë dinarë (rreth 170 euro) për rreth 5 mijë serbë të papunë dhe 'në vështirësi ekonomike' në Kosovë.

Ky veprim përbën ndërhyrje të jashtme në procesin zgjedhor të Kosovës dhe paraqet një përpjekje të hapur për ta influencuar vullnetin qytetar të komunitetit serb, duke përdorur ndihmën financiare si mjet për të ndikuar në përcaktimin politik të votuesve.

Në tërësi gjatë dy javëve të para, DnV ka monitoruar 377 tubime publike (160 në javën e parë, ndërsa 217 aktivitete të tjera në javën e dytë) të subjekteve politike, në të gjitha komunat e vendit, duke përfshirë edhe ato me shumicë serbe.

Me numrin më të madh të aktiviteteve po vazhdon të prijë LDK-ja me 109 aktivitete, ndjekur nga PDK-ja me 106 aktivitete, LV-ja me 71 aktivitete, si dhe AAK-ja me 54 aktivitete. Aktivitete kanë mbajtur edhe subjektet e tjera si Lista për Familjen, si dhe subjektet e komuniteteve të tjera, si Lista Serbe, Za Slobodu Pravdu i Opstanak, Srpska Demokratija, IRDK, PRBK etj.

Subjektet politike i kanë koncentruar tubimet e tyre publike nëpër qendrat kryesore, përfshirë Prizrenin (45 aktivitete), Prishtinën (27 aktivitete), Pejën (23 aktivitete) dhe Gjilanin (22 aktivitete).

Liria e grumbullimit

Përgjithësisht aktivitetet janë organizuar në harmoni me dispozitat ligjore sa i përket paralajmërimit të tyre në KKZ. Megjithatë, në 14 raste vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar se aktivitetet e subjekteve politike janë mbajtur pa u paralajmëruar në KKZ. Objektet publike vazhdojnë t'i mbajnë takimet në lokacione të preferuara për organizimin e aktiviteteve, me rreth 80 % të aktiviteteve të organizuara nëpër palestra sportive, shtëpi kulture, shkolla etj., kurse 20 % të aktiviteteve të tjera janë mbajtur në hapësira private si në restorante apo salla.

Pjesëmarrja qytetare në aktivitete

Interesimi qytetar për pjesëmarrje në fushatë vazhdon të jetë mesatar. Në këto 14 ditë të fushatës, 47 % e aktiviteteve ishin me deri në 200 pjesëmarrës. Kurse aktivitete të tjera, përfshirë ato të vogla me deri në 50 pjesëmarrës (25 % e aktiviteteve), 200 deri në 500 (15 % e rasteve), si dhe tubimet e mëdha me mbi 500 pjesëmarrës (13 % e rasteve), ishin më pak të shprehura. Në anën tjetër, gjatë javës së dytë nuk është shënuar ndonjë rast i ri i pjesëmarrjes së organizuar të nxënësve, përtej 5 rasteve të evidentuara dhe raportuara gjatë javës së parë.

Përdorimi i gjuhës së drejtë dhe jodiskriminuese

Trendi i përdorimit të gjuhës dhe diskursit nxitës apo të urrejtjes në fushatë ka vijuar edhe gjatë javës së dytë pavarësisht prej gjobave të shqiptuara nga PZAP-ja pikërisht për raste të tilla. Deri më tani në 62 aktivitete (rreth 20 % e numrit të përgjithshëm të aktiviteteve) të monitoruara nga DnV-ja janë raportuar raste të

përdorimit të gjuhës nxitëse apo të urrejtjes mes partive dhe kandidatëve të tyre. Në raport me numrin e aktiviteteve të mbajtura, prin Lëvizja Vetëvendosje – në rreth 25 % e aktiviteteve të së cilës ka pasur përdorim të gjuhës nxitëse apo të urrejtjes, kryesisht mbi baza politike. Më tutje renditen LDK-ja (20 % të aktiviteteve), AAK-ja (rreth 18 % të aktiviteteve) dhe PDK-ja (rreth 11 % të aktiviteteve).

Fushata në hapësirën online

DnV-ja deri më tani ka monitoruar në total 679 kandidatë për deputetë, prej të cilëve 447 janë burra dhe 232 gra. Gjatë javës së dytë janë identifikuar deri në 250 raste të: i) Gjuhës denigruese dhe nxitjes së urrejtjes, veçanërisht në videot e realizuara nga subjektet politike dhe të shpërndara në rrjetet sociale; ii) Gjuhës së urrejtjes dhe përcmuese nga palët e treta, të cilat shpesh shfaqen në komentet e postimeve të kandidatëve për deputet/e; iii) Lajmeve të pavërteta, të cilat krijojnë dezinformim dhe përhapin mesazhe që rrezikojnë integritetin e fushatës.

Kosova me platformë për mbrojtje nga sulmet kibernetike

PRISHTINË, 27 JANAR - Agjencia për Informim dhe Privatësi ka shënuar Ditën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "T" i mbrojmë të dhënat personale sot, për një të nesërme të sigurt". Gjatë konferencës së sotme për lansimin e platformës së parë në Kosovë për identifikimin e rrjedhjes së të dhënave personale, në fjalën hyrëse komisionarja për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dërmaku, ka njoftuar se me përkushtim dhe seriozitet të lartë, Agjencia ka fituar statusin e anëtares vëzhguese në Bordin Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB), autoritetin më të lartë evropian për standardet e mbrojtjes së të dhënave. "Ky avancim na mundëson qasje të drejtpërdrejtë në politikat dhe standardet më të avancuara evropiane, duke ndikuar në profesionalizmin tonë, rritjen e besimit dhe forcimin e pozitës së Kosovës në arenën ndërkombëtare", tha komisionarja Dërmaku. Në të arriturat e Agjencisë, komisionarja ka theksuar



përpjekjet shumëdimensionale të Agjencisë për ndërgjegjësimin e kontrolluesve publikë dhe privatë për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale, që përfshijnë, organizimin e mbi 200 aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese, nxjerrjen e 311 vendimeve dhe realizimin e 324

inspektimeve në sektorin publik dhe privat si dhe publikimin e 6 udhëzuesve për mbrojtjen e të dhënave personale. Zëvendësuesi i Misionit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Rahan Hill, nënvizoi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale si një

komponent thelbësor të sigurisë kibernetike. "Krimet kibernetike nuk njohin kufij gjeografikë, ndërsa përbëjnë një kërcënim global. Për këtë arsye, Ambasada Amerikane, përmes Departamentit të Drejtësisë (INL), ka mbështetur Agjencinë në implementimin e një mekanizmi që identifikon rrjedhjet e të dhënave dhe siguron mbrojtjen e informacionit publik", tha ai. Ndërsa zëvendësambasadori i Kroacisë në Kosovë, Nedjelko Spilek, vlerësoi bashkëpunimin dypalësh në mes të Kosovës dhe Kroacisë, duke përmendur rëndësinë e promovimit të standardeve evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale. "Kroacia është e përkushtuar ta ndajë përvojën dhe njohuritë me Kosovën, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve tona dhe duke avancuar zbatimin e standardeve më të larta evropiane për mbrojtjen e privatësisë", u shpreh Spilek. Drejtori i Departamentit për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale në AIP, Arbian Arifi, paraqiti obligimet ligjore të institucioneve publike dhe private, duke theksuar rolin e zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale për zbatimin e ligjit karshi zhvillimeve teknologjike. Erblind Morina nga Sense Cyber Research ka paraqitur platformën për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale përmes identifikimit të rrjedhjes së të dhënave nga kontrolluesit publikë dhe privatë. "Kjo platformë do ta përmirësojë ndjeshëm zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe do të funksionojë si një mekanizëm parandalues ndaj keqpërdorimeve të mundshme të të dhënave", u shpreh Morina. Ngjarja shënoi një çast të rëndësishëm për ta theksuar rolin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe inovacionit teknologjik në Kosovë në forcimin e mbrojtjes së të dhënave personale, duke i kontribuar një të ardhmeje më të sigurt për qytetarët dhe institucionet e Kosovës.

Monitorimi i 152 portaleve ka identifikuar gati 900 mijë komente të bëra në rrjete sociale, ku 6 % e tyre përmbajnë gjuhë të urrejtjes. Këto pasqyrojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes në komunikimet politike, duke ndikuar negativisht në diskursin publik dhe demokratik të vendit. Gratë që kandidojnë për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 janë përballur me gjuhë të urrejtjes në hapësirat online. 7 % e komenteve në rrjete sociale janë identifikuar si gjuhë urrejtjeje. Kandidatet më të sulmuara janë: Besa Kabashi Ramaj - nga 38 artikuj ku ajo përmendet, 16 % përbëjnë gjuhë të urrejtjes; Jeta Statovci - nga 29 artikuj ku ajo përmendet, 16 % përbëjnë gjuhë të urrejtjes; Albulena Haxhiu - nga 167 artikuj ku ajo përmendet, 10 % përbëjnë gjuhë të urrejtjes.

Barazia gjinore dhe gjithëpërfshirja

Pjesëmarrja e grave mbetet tejet e ulët, ku në mbi gjysma e aktiviteteve (55 %) ka pasur pjesëmarrje minimale të grave - me vetëm deri në 10 % të pjesëmarrësve. Sa i përket pjesëmarrjes aktive në garë zgjedhore, ende vetëm 1/3 e fjalimeve janë mbajtur nga gratë. Prani e njëjtë e ulët e grave është shënuar edhe në medie. Edhe kohëzgjatja televizive në kronika zgjedhore ka qenë dukshëm më e ulët për gratë në krahasim me burrat. Vetëm 28 minuta apo 10 % e hapësirës televizive u është dhënë grave. Edhe debatet televizive janë dominuar nga pjesëmarrësit burra, me vetëm 44 (22 %) kandidatë gra që kanë marrë pjesë në 174 debate të mbajtura. Sa i përket përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, vetëm në 5 raste të njëjtit kanë mbajtur fjalime në aktivitetet e fushatës.

Mesazhet politike

Top temat dhe çështjet e trajtuara gjatë fjalimeve apo mesazheve politike mbeten arsimi, ekonomia, mirëqenia sociale dhe shëndetësia. Parë sipas partive, vërehet orientim i ndryshëm i temave të fushatës, mes partisë në pushtet dhe atyre në opozitë. Derisa Lëvizja Vetëvendosje tema bosht të fushatës ka vijuar t'i ketë veriuin e vendit (53 raste) dhe mirëqenien sociale (50 raste), partitë opozitare janë fokusuar më shumë te tema si arsimi, ekonomia, shëndetësia e infrastruktura. Të tri subjektet opozitare, LDK (87 raste), PDK (86 raste) dhe AAK (40 raste), e kanë pasur temë qendrore të fushatës së tyre arsimin. Kryesisht mesazhet politike kanë vijuar të shpalosen nga liderët dhe persona të caktuar të partive, pa iu dhënë mundësia të gjithë kandidatëve që vijnë nga komunat përkatëse ku po mbahen aktivitetet.

Liria e shprehjes dhe e informimit

Në javën e dytë nuk kanë munguar prezantimet e partive dhe kandidatëve në mediae Përrjashtim relativ përbën ende Lëvizja Vetëvendosje, kandidatët e së cilës, ndonëse kanë marrë pjesë në disa debate dhe diskutime, kanë vijuar me bojkotin selektiv ndaj shumicës së medimeve private. Kronikat zgjedhore janë dominuar përgjithësisht nga subjektet e mëdha, ku 277 nga 345 kronikat e monitoruara janë për këto subjekte - PDK-171, LDK-169, Koalicioni AAK/NISMA-154 dhe LV-151. Sa i përket hapësirës brenda subjekteve, pjesa më e madhe u



është kushtuar kandidatëve për kryeministër dhe liderëve të listave garuese, me gjithsej 414 minuta.

Parandalimi i keqpërdorimit të resurseve publike për qëllime elektorale

Gjatë javës së dytë të fushatës zgjedhore është shënuar trend pothuajse i njëjtë i keqpërdorimit të resurseve publike për qëllime elektorale. Krahasuar me javën e parë, kur ishin evidentuar gjithsej 18 raste, në javën e dytë janë shënuar 12 raste të tjera, duke e çuar numrin e përgjithshëm në

31 raste. Në 13 aktivitete është vërejtur prani e veturave zyrtare, 15 prej të cilave të organizuara nga partitë opozitare (LDK dhe AAK), kryesisht në komunat ku ato qeverisin, ndërsa në 2 raste të nivelit qendror kur janë mbajtur aktivitete nga partia në pushtet. Po ashtu, në 18 aktivitete të tjera janë vërejtur zyrtarë publikë si nëpunësit civilë, personeli arsimor apo shëndetësor, gjatë orarit të rregullt të punës. Në mesin e këtyre rasteve, 8 janë aktivitete të organizuara nga LDK, 7 të aktiviteteve organizuara nga PDK, si dhe nga 1 aktivitet të organizuar nga LV dhe AAK, respektivisht. Institucionet e angazhuara në zgjedhje kanë pasur dinamikë të

shtuar të punës gjatë javës së fundit dhe në përgjithësi në këto dy javë të fushatës. PZAP-ja ka shqyrtuar dhe vendosur deri më tani në 45 raste që ndërliken me shkeljet e kodit të mirësjelljes gjatë fushatës, si dhe çështje të tjera të ndërlihdura me personelin zgjedhor në nivel komunal. PZAP ka shqyrtuar 30 vendime me gjobë në vlerë prej 155 mijë e 500 eurosh gjobë, kryesisht për shkak të gjuhës së përdorur në fushatë, përdorimit të resurseve publike në kundërshtim me ligjin, si dhe vendosjes së materialit zgjedhor (posterët) në hapësira publike në kundërshtim me ligjin, ndërsa ka hedhur poshtë 15 ankesa si të pabazuara.

Partia në pushtet, si para 4 vitesh: Shumë premtime dekorative (sterile) për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit



**Shkruan: Prof.
dr. Fejzulla BERISHA**

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, me afrimin e zgjedhjeve të shkurtit 2025, është e rëndësishme që të bëni një zgjedhje të informuar dhe të kujdesshme për subjektin politik që do të mbështesni. Zgjedhjet nuk janë vetëm një mundësi për të përcaktuar përfaqësuesit që do të drejtojnë vendin, por edhe një mundësi për të rivlerësuar angazhimet dhe përmbushjen e premtimeve të partive politike ndaj qytetarëve, të cilët janë vlerësuar në baza zgjedhore.

Ky është një moment për të analizuar dhe për të parë se sa janë realizuar premtimet e bëra në periudhat e mëparshme zgjedhore, duke u përqendruar jo vetëm në përmbushjen e tyre, por edhe në mungesën e angazhimeve të vërteta që i janë dhënë shoqërisë. Për të marrë një vendim të informuar dhe të drejtpërdrejtë, duhet të vlerësoni nëse premtimet janë të realizueshme, të bazuara në realitet dhe të përshtatshme për zhvillimin e vendit dhe mirëqenien e qytetarëve.

Analiza e premtimeve të partive politike

Në vitet e fundit, partitë politike në Kosovë kanë shpallur shumë premtime të mëdha që kanë tërhequr mbështetje dhe kanë ngritur shpresat te qytetarët. Por, shumë prej këtyre premtimeve kanë mbetur të parealizueshme, përderisa disa janë bërë thjesht për të përfutur politikisht gjatë periudhave zgjedhore. Ky fenomen nuk është i kufizuar vetëm në Kosovë, por është i pranishëm dhe i dukshëm në shumë shtete të rajonit, si në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë. Këtu, liderët politikë shpesh përdorin retorikë të ngjashme për të tërhequr vota, duke përdorur slogane dhe premtime që, në shumicën e rasteve, janë të parealizueshme dhe të paqëndrueshme.

Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimi i administratës shtetërore

Një nga premtimet më të përfolura gjatë fushatave zgjedhore të partive politike në Kosovë ka qenë lufta kundër korrupsionit dhe ndërtimi i një administrate shtetërore të pastër. Ky ishte një premtim që gjithashtu u shfaq në fushatat zgjedhore të shumicës së partive politike që kanë udhëhequr vendin në të kaluarën. Sidoqoftë, ende nuk ka pasur hapa të dukshëm që do të çonin në ndëshkrimin e korrupsionit në nivele të larta dhe në pastrimin e administratës publike. Disa raporte të organizatave ndërkombëtare si Transparency International kanë theksuar se Kosova mbetet ende një nga shtetet me nivelin më të lartë të perceptuar të korrupsionit në rajon dhe më gjerë.

Në vendet e tjera të rajonit, si në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, janë bërë përpjekje të ngjashme për të luftuar korrupsionin, por edhe atje shumë premtime kanë mbetur të parealizueshme. Për shembull, në Shqipëri, reforma në sistemin gjyqësor dhe lustrimi i administratës kanë ngelur të pa realizuara, ndonëse janë bërë deklarata të shpeshta për të goditur korrupsionin dhe pastruar

institucionet.

Në Kosovë, një nga shembujt më të shquar është Ligji i Lustracionit, i cili është miratuar për të pastruar administratën publike nga individë të akuzuar për korrupsion. Megjithatë, ky ligj ka ngecur dhe nuk është zbatuar ashtu siç ishte planifikuar. Në disa raste, individë të akuzuar për korrupsion janë riemëruar në pozita kyçe, duke treguar se politika e re nuk ka mundur të largojë praktikatat e keqveerisjes.

Zhvillimi ekonomik dhe papunësia

Një tjetër premtim që ka mbetur shumë larg realizimit është ai për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Në fushatat zgjedhore, partitë politike në Kosovë kanë premtuar rritje të investimeve dhe mundësi punësimi për të rinjtë, si dhe ndihma për të stimuluar zhvillimin ekonomik. Megjithatë, Kosova ka mbetur një nga vendet me nivelin më të lartë të papunësisë në rajon, sidomos në mesin e të rinjve. Sipas të dhënave të Bankës Botërore dhe të organizatave ndërkombëtare, papunësia e të rinjve është një problem i thellë që po pengon zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo është një çështje që është gjithashtu e pranishme në shumë shtete të Ballkanit Perëndimor, ku

qeveritë shpallin strategji dhe paketa stimuluuese ekonomike, por ato nuk kanë pasur ndikim të dukshëm për uljen e papunësisë.

Integrimi evropian

Një premtim tjetër që është shpallur vazhdimisht nga partitë politike është integrimi në Bashkimin Evropian dhe liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. Megjithatë, pas shumë viteve të përpjekjeve dhe premtimeve, Kosova ka mbetur ende pa një datë për fillimin e procesit të anëtarësimit në KE dhe BE. Mekanizmat kompetent të Republikës së Kosovës vazhdojnë të përballen me pengesa të shumta burokratike dhe administrative për të integruar në KE/BE-së, ndërkohë disa shtete në rajon, siç janë: Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, kanë arritur të përfitojnë nga integrimet evropiane etj.

Manipulimi i qytetarëve dhe praktikatat e zakonshme të fushatave zgjedhore

Për shumë vite, partitë politike në Kosovë kanë përdorur manipulimin e qytetarëve gjatë fushatave zgjedhore. Kjo ka përfshirë përdorimin e diskursit të ngjashëm dhe të njohur, si

dhe shpalljen e premtimeve që kanë ngjallur pritshmëri të mëdha, por që nuk janë përmbushur kurrë. Kjo praktikë është shumë e përhapur në rajon, përfshirë në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, ku liderët politikë shpesh përdorin simbolikë kombëtare dhe emocione për të tërhequr mbështetje, pa ofruar ndryshime të prekshme për jetën e përditshme të qytetarëve.

Në Maqedoninë e Veriut, partitë politike kanë shpallur shumë herë fushata për të luftuar korrupsionin dhe për të sjellë ndryshime të mëdha shoqërore, por shumë nga këto premtime janë dëshmuar të rreme dhe pa ndonjë efekt konkret në jetën e qytetarëve. Po ashtu, në Shqipëri, partitë shpesh premtuan zhvillim ekonomik dhe rritje të standardit të jetesës, por shumë nga këto premtime janë mbetur të paplotësuara pas zgjedhjeve.

Rëndësia e informimit dhe vlerësimit kritik

Për të bërë një zgjedhje të informuar dhe të përgjegjshme, qytetarët duhet të:

1. Hulumtojnë historikun e partive politike: Shikoni se cilat premtime kanë bërë në të kaluarën dhe në çfarë mase i kanë realizuar ato. Kjo mund të bëhet duke studiuar raporte të organizatave ndërkombëtare si Komisioni Evropian dhe Transparency International, të cilat vlerësojnë progresin e Kosovës në fusha të ndryshme.
2. Lexoni programe të detajuara: Analizoni programet aktuale të partive dhe verifikoni nëse premtimet e tyre janë të realizueshme dhe të bazuara në realitet. Kërkoni shpjegime të detajuara për mënyrën e implementimit të projekteve të propozuara dhe financimin e tyre.
3. Konsultoni burime të pavarura: Shfrytëzoni analizat nga organizata të pavarura dhe media të besueshme për të marrë një pasqyrë objektive të performancës së partive dhe liderëve politikë.
4. Diskutoni me bashkëqytetarët: Bisedoni me njerëz të tjerë, ndihmohuni të kuptoni perspektiva të ndryshme dhe formoni një opinion të qëndrueshëm dhe të argumentuar. Duke ndjekur këto hapa, qytetarët mund të bëjnë zgjedhje më të informuara dhe të kontribuojnë në ndërtimin e një shteti më të fortë, të zhvilluar dhe të drejtë. Zgjedhja juaj është vendimtare për të ardhmen e Kosovës dhe për realizimin e potencialeve të saj.



IPK-ja: Vetura e policisë nuk iu përshtat shpejtësisë dhe goditi veturën civile në Skenderaj, humbën jetën tre qytetarë

PRISHTINË, 27 JANAR - Inspektorati Policor i Kosovës tha se aksidenti me fatalitet në Çubrel të Skenderajt dyshohet se ndodhi për shkak të mospërshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes nga vetura e Policisë së Kosovës.

Më 26 janar, në rrugën rajonale Mitrovicë - Pejë në fshatin Çubrel, vdiqën tre civilë, pasi një veturë e policisë u aksidentua me një veturë civile.

IPK-ja tha se, sipas hetimeve fillestare, automjeti policor nuk

kishte përshtatur shpejtësinë me kushtet e rrugës dhe kishte kaluar në shiritin e kundërt duke goditur veturën civile. Për shkak të kësaj, IPK tha se ka rekomanduar suspendimin e zyrtarit policor i cili ka qenë drejtues i automjetit që u aksidentua.

Si pasojë e këtij aksidenti kanë mbetur të lënduar katër zyrtarë policorë dhe një qytetar nga vetura civile që, sipas IPK-së, kanë pësuar lëndime të rënda trupore.

Pas këtij aksidenti që ndodhi rreth orës 19:00 të së dielës, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka bërë thirrje qytetarëve të kenë kujdes në komunikacionin rrugor për t'i shmangur fatkeqësitë.

Kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, tha se në aksident kanë humbur jetën anëtarë të familjes Gashi nga Peja. "Kjo është një humbje e madhe për qytetin tonë dhe një moment pikëllimi të thellë për të gjithë ne", tha ai.



Lidhur me aksidentin me fatalitet ka reaguar edhe kryeparlamentari Glauk Konjufca. Ai ka thënë se është i tronditur nga kjo ngjarje dhe u ka shprehur ngushëllime familjarëve të viktimave. "Të

lënduarve të tjerë shërim sa më të shpejtë", ka shkruar Konjufca në "Facebook".

Policia paraprakisht kishte njoftuar se në hetimet e kësaj ngjarjeje ishte përfshirë edhe IPK-ja.

Shtyhet seanca fillestare ndaj të akuzuarve për vrasjen e Liridona Ademajt

PRISHTINË, 27 JANAR - Seanca fillestare për katër të akuzuarit për vrasjen e Liridona Ademajt është shtyrë për 31 janar, në orën 11:00, pasi ekipet mbrojtëse thanë se nuk kanë pranuar shkresat e lëndës dhe nuk ka kushte për mbajtjen e kësaj seance sot.

Gjykatësja i paralajmëroi avokatët që në këtë datë të re të jenë të përgatitur.

Në Gjykatën Themelore avokati i të akuzuarit, Kushtrim Kokalla, tha se kjo seancë nuk mund të mbahet, pasi pretendoi se nuk ka pranuar aktakuzën, shkresat e tjera të lëndës dhe CD-të me prova për këtë rast. Ai tha se nuk është në gjendje ta këshillojë klientin e tij as si të deklarohet për akuzat e as nuk mund t'i kundërshtojë provat. "Për mua nuk janë plotësuar kushtet që të mbahet kjo seancë", tha avokati Ndreç Dodaj.

Por, prokurorja e rastit tha se shkresat, CD-të dhe aktakuzat janë dorëzuar më 22 janar te avokati i Granit Plavës, i cili e ka pranuar aktakuzën edhe për avokatin e Kokallës. Dokumentet ai tha se i dorëzoi të hënën avokatit para se të niste seanca.

Avokatët e të akuzuarve Kushtrim Kokalla dhe Tomë Dodaj thanë, po ashtu, se s'kanë marrë shkresat pasi nuk po u bënë emaili. Ata, gjithashtu, kërkuan shtyrjen e seancës. "Është e vërtetë që kam pasur probleme me email. Sot e kam marrë aktakuzën. Nuk kam shkresa të tjera të lëndës", tha Agron Kuçi, avokati i Tomë Dodajt.

Avokati i Kokallës u dënua me 500 euro për prishje të rendit në seancë: mosbindje ndaj gjyqtarës.

Në seancë të pranishëm ishin tre persona të akuzuar për këtë rast, përfshirë edhe bashkëshortin e Liridonës, Naim Murseli.

Fillimisht gjykatësja i pyeti të akuzuarit për informacionet e përgjithshme, sikurse datëlindja e tyre, statusi martesor, niveli i arsimit, gjendja ekonomike e të ngjashme.

Para nisjes së seancës së sotme - që u shty nga gjykatësja e rastit - familja e Liridonës tha se beson në drejtësi dhe shpreson që gjykimi të jetë "efikas, profesional, pa gabime, pa vonesa dhe transparent".

Më 15 janar të këtij viti Prokuroria Themelore në Prishtinë njoftoi se kishte ngritur aktakuzë ndaj katër personave për vrasjen e 30 vjeçes Ademajt.

Liridona Ademaj u vra më 29 nëntor 2023, në rrugën "Dalip Alshiqi" në Prishtinë.

Rasti fillimisht ishte raportuar si "grabitje me pasoja të vrasjes", por dy ditë më vonë autoritetet kishin arrestuar dy persona. Në mesin e tyre ishte edhe bashkëshorti i Liridonës, Naim Murseli.

Të akuzuarit e tjerë janë Kushtrim Kokalla, Granit Plava dhe një person i katërt, emri i të cilit nuk është përmendur nga prokurorët kur ata njoftuan për ngritjen e aktakuzës.

Prokurorja e rastit, Javorca Përlinçeviq, gjatë konferencës më 15 janar, tha se gjatë kohës që çifti jetonte në Suedi - së bashku me dy fëmijët e tyre - ata kishin pasur "marrëdhënie të trazuarra martesore", si pasojë e të cilave erdhën edhe problemet pronësore. "Arsyet e tjera që kishte Naimi për të planifikuar dhe kryer këtë vrasje



mund t'i mësoni në gjykatë kur të fillojë seanca kryesore", tha Përlinçeviq, e cila tha se gjetja e motivit të vrasjes kishte bërë që procesi i ngritjes së aktakuzës të merrte më shumë kohë.

Prokurorja tha se deri te ky informacion erdhën në bashkëpunim me autoritetet suedeze, pasi nga to Prokuroria në Prishtinë kishte kërkuar të dhëna rreth jetës së çiftit dhe marrëdhënies së tyre martesore. "Vetëm atëherë arritëm të krijojmë një pamje të plotë të jetës së tyre dhe ta gjejmë motivin që e shtyu Naim Murselin ta marrë vendimin për largimin e Liridonës, për të mos thënë likuidimin e saj, sepse mënyra e kryerjes së veprës tregon qartë një akt të tillë si likuidim", deklaroi Përlinçeviq. Ndërkaq, kryeprokurori i

Prokurorisë në Prishtinë, Zejnullah Gashi, tha se vrasja e kryer nga "anëtar i familjes" u krye në "mënyrë dinake", prandaj shtoi se pret dënim kapital nga gjykata. Sipas Prokurorisë, Naim Murseli kishte "planifikuar gjithçka", ndërkaq Kokalla dhe Plava, sipas organit ndjekës, ishin "ekzekutues të drejtpërdrejtë" të Liridonës. I akuzuari i katërt, sipas Prokurorisë, është i përfshirë në mënyrë të tërthortë në këtë rast.

Murseli, Kokalla dhe Plava gjenden në paraburgim, ndërkaq personit të katërt i është ndërprerë kjo masë dhe po mbrohet në liri. Ai ishte arrestuar më 9 dhjetor nën dyshimin se ia kishte shitur armën dorasit.

Familja e Liridonës kishte

kërkuar zhvarrosjen e trupit të saj, në mënyrë që ajo të varrosej vranë varrezave të prindërve të saj, ndërkaq aktivistët për të drejtat e grave kanë kërkuar që Liridona të mos identifikohet më me mbiemrin e bashkëshortit, por me atë të familjes së saj, Ademaj. Zemërim të madh në publik kishte shkaktuar edhe fakti që burri i saj kishte qenë pjesë e ceremonisë së varrimit të Liridonës.

Që nga viti 2010 e deri më tani në Kosovë janë vranë afër 60 gra. Në të shumtën e rasteve, doras kanë qenë bashkëshortët. Sipas organizatave që merren me të drejtat e grave, mesazhe "trimëruese" dorasëve është duke u dërguar sistemi i drejtësisë në Kosovë me, siç thuhet, "dënimet e lehta". /REL/

Skandaloze: Rekrutët e rinj të FSK-së ushtrojnë me atlete, nuk kanë mbathje ushtarake




PRISHTINË, 27 JANAR - Qeveria Kurti në vazhdimësi është mburrur për investime në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), por faktet dëshmojnë

të kundërtën. Pas skandalit me ushqim, Ministria e Mbrojtjes i ka lënë ushtarët e FSK-së pa mbathje ushtarake. Në faqen zyrtare

të FSK-së në "Facebook" është njoftuar se të hënën kanë filluar trajnimin 354 rekrutë të rinj. Ajo që bie në sy në fotografitë e

publikuara nga FSK-ja shihen disa ushtarë të rinj, të cilët, në vend të mbathjeve ushtarake, kanë atlete.

Ekonomia e Kosovës: Shumë premtime, pak përparime



PRISHTINË, 27 JANAR - Kur ka paraqitur programin e qeverisë së tij në maj të vitit 2021, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se potenciali i madh i prodhimit të ushqimit në Kosovë duhet të shfrytëzohet jo vetëm për nevoja të brendshme, por edhe për të eksportuar. Ai ka thënë se do të angazhohet për blerjen e makinerive prodhuese dhe përpunuese për eksport, si dhe do t'i ndihmojë bizneset në gjetjen e tregjeve për eksport.

Në kuadër të mbështetjes për to, ka thënë se Kosova do ta themelojë edhe Bankën Zhvillimore. "Ajo do të jetë mekanizëm për mbështetjen e sektorit privat dhe promovimin e investimeve. Ajo do të jetë komponenti kreditues që do të financohet nga paratë publike dhe shitja e letrave të borxhit, duke investuar në degë të caktuara të industrisë, që krijojnë vende pune dhe përmirësojnë bilancin tregtar", ka thënë Kurti në vitin 2021.

Katër vjet më vonë kjo bankë nuk është themeluar dhe bilanci tregtar nuk është se ka ndryshuar. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe të Doganës së vendit tregojnë se në vitin 2021 vlera e eksporteve në Kosovë ka qenë 775.7 milionë euro, kurse e importeve 4.6 miliardë euro.

Në vitin 2024 eksportet janë rritur në 990.2 milionë euro, por edhe importet në 6.3 miliardë euro. Kurti edhe në fushatën për zgjedhjet e 9 shkurtit - në të cilat do të garojë për mandatin e dytë si kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje - bën premtime të ngjashme. "Do të ofrojmë mbështetje deri në një miliard euro për investime të mesme e të mëdha në ndërmarrjet prodhuese cep më cep Kosovës. Do ta shtojmë prodhimin, do ta shtojmë investimin, do ta

mundësojmë riinvestimin dhe do ta rrisim eksportin", ka thënë Kurti në një tubim me mbështetësit e tij në Gjakovë.

Me këso premtimesh mbështetësve u drejtohen edhe kundërkandidatët e tij.

Bedri Hamza i Partisë Demokratike të Kosovës ka thënë se do të ndajë mbi 6 miliardë euro për projekte kapitale dhe zhvillimore. "Ne nuk i ofendojmë bizneset private. Ne do t'i mbështesim bizneset private. Në qeverinë time nuk do të ketë më pagesa të TVSh-së në kufi, por në brendi të Kosovës, pas shitjes së produkteve dhe jo përpara", u ka thënë Hamza mbështetësve në Skenderaj.

Për Lumir Abdixhikun e Lidhjes Demokratike të Kosovës bizneset krijojnë vende të reja të punës, eksportojnë dhe ulin deficitin e lartë tregtar. Është "paradoks i kohës", sipas tij, që ato edhe sot e kësaj dite përballen me mungesë të energjisë elektrike. "Pas 9 shkurtit, Qeveria e Kosovës, qeveria e djathtë, bizneset i sheh si partnere. Do të punojë me to dhe do ta bëjmë Kosovën me to", ka thënë Abdixhiku gjatë një vizite në një kompani për konstruksione metalike.

Këtë pikëpamje për bizneset, në disa tubime me mbështetës, e ka ndarë edhe Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. "Duhet të dërgojmë sinjale të qarta se biznesi është partner. Bizneset janë vlerë e shtuar, krijojnë buxhet, krijojnë investime. Duhet t'i fuqizojmë sipërmarrësit tanë, jo vetëm të mëdhenjtë dhe jo vetëm disa, por çdo sipërmarrës të Kosovës duhet ta kemi partner", ka thënë Haradinaj para mbështetësve në Rahovec.

Secila prej këtyre partive në periudha të ndryshme pas pavarësisë e këndeja ka qenë ose në krye të Qeverisë së Kosovës,

ose partnere koalicioni. Subvencione për bizneset ka pasur aty-këtu.

Në konferencën e fundvitit të kaluar me afaristë, Kurti ka thënë se, për tre vjet u ka shpërndarë bizneseve 1.3 miliardë euro në formë të granteve dhe programeve të tjera, për të forcuar konkurrencën e tyre në tregjet vendore dhe ndërkombëtare. Por, bilanci tregtar nuk është përmirësuar asnjëherë. Kosova çdo vit importon mesatarisht 5 miliardë euro mallra, nisur nga qepët, domatet e mollët deri te materialet ndërtimore, ndërsa eksporton në vlerën e më pak se 1 miliardë eurove, kryesisht produkte të metalit dhe plastikës. Prodhuesit e Kosovës ankohen vazhdimisht për Tatim të Lartë mbi Vlerën e Shtuar, për ekonomi joformale, kamata të larta për kredi, mungesë infrastrukture, jostabilitet me rrymë e të tjera.

Ramiz Gashi prej vitesh udhëheq kompaninë "Relux" jashtë Prishtinës, e cila merret me prodhimin e ngjyrave dhe të fasadave. Me mbi 40 të punësuar ai thotë se kompania ka arritur të eksportojë në 11 vende të botës, përfshirë Gjermaninë, Francën, Britaninë e Qipron - të gjitha me forcat e veta. "Deri më tani, që sa vite operojmë... jo vetëm kjo qeveri e tanishme që bën premtime shumë, por edhe të kaluarat që kanë bërë premtime të njëjta, asnjëra prej tyre nuk na ka dalë në ndihmë, pa marrë parasysh se çfarë kërkesash kemi pasur - ndoshta edhe një kërkesë sa më elementare", thotë Gashi për programin "Expose" të Radios Evropa e Lirë.

Gashi tregon se biznesi i tij, sa herë që bie shi, rrethohet nga uji, për shkak të infrastrukturës së dobët të kanalizimit përreth. Ky problem, sipas tij, e pengon punën e biznesit dhe do të duhej

të zgjidhej me urgjencë. "Ne kemi bërë disa herë kërkesa, protesta e peticione, jo vetëm ne, por të gjitha bizneset që operojnë këtu, dhe të gjitha kanë hasur në veshë të shurdhër", thotë Gashi.

Ky biznesmen shpreh bindjen se mund të bëhet gjigant i madh eksportues dhe të ndikojë edhe në rregullimin e bilancit tregtar, nëse merr një dorë nga shteti. "Ne nuk kërkojmë që të na jepet diçka krejt falas, por të paktën të na mundësohet ndonjë kredi me kamatë më të favorshme dhe të kemi ndonjë lehtësirë. Këtë e presim nga qeveritë në ardhje", thotë Gashi.

Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, thotë se cilado parti që krijon qeverinë, e ka mundësinë t'i realizojë premtimet ndaj bizneseve, nëse do që t'i trajtojë ato me seriozitet. Sipas tij, Kosova nuk e ka luksin për ta pasur borxhin publik në 17 për qind të bruto prodhimit të brendshëm, kur me ligji mund të shkojë deri në 40 për qind, dhe ta shfrytëzojë atë në favor të zhvillimit. "Vendim i parë i qeverisë do të duhej të ishte përcaktimi i sektorëve konkurrues të Kosovës dhe të përqendrohet tek ata, t'i mbështesë, t'i subvencionojë, të marrë masa, qoftë administrative, qoftë në kuptimin e politikave fiskale apo të normave të interesit, në mënyrë që bizneset të prodhojnë sa më shumë, të eksportojnë sa më shumë dhe ta zbresin importin që e kemi kaq të lartë", thotë Rafuna për "Exposenë".

Në mënyrë konkrete, ai numëron edhe tre hapa: reformën e Tatimit të Vlerës së Shtuar, lirinë e më shumë lëndëve të para dhe diplomacinë ekonomike. Rritja e prodhimit, e rrjedhimisht eksportit, pastaj është e garantuar. "Duke ia krijuar kushtet biznesit, ti përveçse e rrit

atë biznes që e ke brenda Kosovës, motivon edhe ardhjen e investitorëve të huaj. Ne duhet ta kemi parasysh se Kosova nuk mund të zhvillohet e vetme dhe duke u mbyllur. Është urgjente për Kosovën që t'i bashkohet çdo iniciative që promovon tregun e hapur të importimit dhe eksportimit të produkteve", thotë kryetari i OEK-ut.

Lekë Musa, ekspert i ekonomisë dhe ish-drejtor i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, thotë se Kosova e ka të pamundur që ta zhvillojë secilën industri, por janë disa, si teknologjia informative, industria e drurit apo e frutave, që mund të shpërthejnë në tregjet e jashtme. "T'i ndihmohet atyre duke u krijuar parakushte dhe politika stimuluese, por në radhë të parë t'iu hiqen barrierat që i pengojnë në baza ditore. Pastaj, ka mundësi për t'i ndihmuar edhe në përmirësimin e cilësisë, edhe në mbërritjen e standardeve që kërkohen në tregjet evropiane", thotë Musa për "Exposenë".

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2023 tregojnë se vendi i ka pasur 68 390 biznese aktive, në krahasim me 81 692 sa i ka pasur në vitin 2022.

Bilanci tregtar pozitiv, sipas ekspertëve, e forcon ekonominë dhe siguron stabilitet financiar. Sipas një parashikimi të Bankës Botërore në tetor të vitit të kaluar, rritja ekonomike në Kosovë këtë vit do të jetë 3.9 për qind, nga 3.8 për qind sa ka qenë vitin e kaluar.

Me popullsi relativisht të re, me tokë të përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme, me burime ujore dhe minerare, Kosova 1.6 milionësh ka shpresë, por kjo shpresë merr formë vetëm kur qeveritë t'i zëvendësojnë premtimet me veprime, mundësisht përpara ciklit të ardhshëm zgjedhor.

Në kohë ekstreme, veprat e tij thonë të pathënën: Pse Sofokliu po pushton teatrin britanik?



Nga: **Charlotte HIGGINS**
(The Guardian)

Teatri në Uest-End [West End, Londër] po ndodhet në një gjendje të çuditshme dhe shqetësuese. Ndihet sikur po shkon drejt fundit ajo që dikur mund të kishte qenë e mirë dhe emocionuese. Shumë nga shfaqjet e mëdha – ato që mund të kenë posterë në metro – janë adaptime të filmave ose serialeve televizive, si *The Devil Wears Prada*. Ose janë realizime të sigurt, si *Mamma Mia!* Ose janë nga ato që kanë aktorë të njohur, si *The Tempest* me *Sigourney Weaverin* – një shfaqje që është kritikuar gjerësisht. Kjo nuk do të thotë se të gjitha këto shfaqje janë të këqija, por ekziston një lloj stagnimi. Producentët po përpiqen të tërheqin një audiencë që ende ngurron të rikthehet në teatër – që nga koronavirusi – në një kohë kur po shteron burimi i materialeve të reja në një botë gjithnjë e më e varfëruar edhe për teatrin e subvencionuar. Megjithatë, në këtë mishmash ka diçka të papritur: shumëçka nga Sofokliu. Sapo ka përfunduar një version i tragjedisë *Edipi Mbret*, ku luajnë *Mark Strong* dhe *Lesley Manville*. Një tjetër sapo është shfaqur në [teatrin] “*Old Vic*”, me *Rami Malekun* dhe *Indira Varman*. Në të njëjtën kohë, një vepër shumë më pak e luajtur e Sofokliut, *Elektra*, po shfaqet në Uest-End me *Brie Larsonin* në rolin kryesor (e njohur nga shumica si *Kapitenia Marvel* në serinë e

filmave të *Marvel-it*).

Pse Sofokliu? Tragjedia greke është një hapësirë ku mund të shtrohen pyetje të pakëndshme. Këto vepra nuk përshtaten me modelin e zakonshëm të një publiku liberal që shikon një shfaqje liberale ku të gjithë bien dakord me njëri-tjetrin. Dhe, veçanërisht *Edipi* i Sofokliut është një vepër e përjetshme, e cila vazhdon të ofrojë kuptime të reja. Është gjithashtu një nga dramat më të strukturuar, e cila shpaloset me një logjikë të paepur në kohë reale. Aristoteli kishte të drejtë kur ka thënë se ishte drama e përsosur.

Në njëfarë mënyre, ishte çështje fati se pse këto produksione u adaptuan në Londër, në kufirin mes viteve 2024 dhe 2025. *Matthew Warchus*, bashkëregjisor i *Edipit* në “*Old Vic*”, ka thënë se versioni i tij, i adaptuar nga dramaturgia *Ella Hickson*, për 30 vjet kishte qenë në listën e tij të dëshirave. Ndërkohë, produksioni i regjisorit *Robert Icke*, ai me aktorët *Strong* dhe *Manville*, fillimisht u shfaq në “*Internationaal Theater*” në *Amsterdam* dhe pastaj në *Britani* në festivalin e *Edinburgut* të vitit 2019, me një kast holandez. Mund të jetë rastësi. Por, Sofokliu – të paktën sipas atyre që po sjellin veprat e tij në skenë – ka diçka për t’i thënë botës sot.

Nuk është e lehtë t’ia ofrosh audiencës së shekullit XXI veprat që vijnë nga një kontekst kaq i largët kulturor, fetar dhe politik. Javën e kaluar e pashë *Elektrën* në “*Theatre Royal*” të *Brajtonit*, para se të

vinte në Uest-End. Ky produksion thekson ngjashmëritë shpesh të përmendura midis kësaj tragjedia dhe *Hamlet-it*: *Larson* lëviz e trazuar në skenë, si një adoleshente e përvuajtur, duke reflektuar mbi urrejtjen që ndien për të ëmën e cila ia kishte vrarë babanë.

Ky tekst paraqet një sfidë të veçantë: futesh në një histori me shumë prapaskena; nëse nuk je i kujdesshëm, mund të duket si sezoni i dytë i një serie. Por, në këtë vepër – edhe pse në këtë produksion qartësia ishte disi e zbehtë – shtrohen pyetje të mëdha dhe të pazgjidshme: A e do më shumë nënën apo babanë? Po sikur njëri prej tyre të kishte vrarë tjetrin? Çfarë do të bëje? Po sikur të kishin një arsye, një justifikim të mundshëm për veprimet e veta? Tragjeditë greke çojnë çdo gjë në ekstrem. Dhe, ne kemi nevojë për këtë: jetojmë në kohë ekstreme.

Versioni i *Edipit* nga *Icke* nuk linte vend për konfuzion. Ai e studioi tekstin grek në detaje dhe më pas krijoi një adaptim – shumë të lirë, duke shtuar personazhe dhe skena të reja, por me një lidhje të thellë me tekstin origjinal. Kori u hoq plotësisht, bashkë me gjithçka që ai nënkupton në një tragjedi greke – idenë se shfaqja po luhet në një hapësirë publike, ku personazhet individuale përballen me diçka që mund të kuptohet si një kolektiv. Kjo, në vetvete, është një simptomë interesante e kohëve tona. Në Evropën Perëndimore të vitit

2025, nuk jetojmë më në një kulturë kolektive, por në një kulturë të atomizuar të post-internetit.

Ky version zhvillohet prapa dyerve të mbyllura, në një hapësirë private, megjithëse bota publike e politikës gjendet shumë pranë – pasi ai e imagjionon *Edipin* si një politikan në natën e zgjedhjeve, duke pritur rezultatet. Ajo që na ofrohet është një shfaqje familjare e përqendruar nga brenda. Sigurisht, kjo do të thotë se humbet një pjesë e madhe e lirikës së Sofokliut, komenteve fetare dhe peshës së tij filozofike. Por, dikush tjetër do ta interpretojë ndryshe nesër, dhe *Warchus* me bashkëregjisorin e tij, koreografin *Hofesh Shechter*, janë shembull i kësaj. Në produksionin e tyre, ata përdorin një kor, edhe pse pa fjalë: një grup valltarësh. *Warchusi* më tha se gjatë punës kishte menduar për [dramën televizive] *The Singing Detective* të *Dennis Potterit*, ku një histori e errët ndërthuret me këngë dhe valle; ai shpreson që kori në *Edipin* e tij “krijon një tension, një valë mbi të cilën mund të lëvizë shfaqja”.

Ndoshta është më mirë të thuhet se *Edipi* është i kushtëzuar nga rrethanat. Çdo interpretim i tij sjell këndvështrime të reja, të cilat ndryshojnë për t’iu përshtatur kohës. Nëse këto tekste kanë nevojë për përshtatje të menduara për t’iu drejtuar një audience moderne, nuk mendoj se kjo do ta shqetësonte Sofokliun i cili


vetë u bazua në një mit të vjetër, të rrëfyer shkurtimisht në *Odisenë* e *Homerit*, dhe atë e transformoi rrënjësisht për të krijuar një shfaqje për audiencën e tij të vitit 429 Para Krishtit.

Pesëmbëdhjetë vjet më parë, do t’ju kisha thënë se *Edipi* ishte, në thelb, historia e parë detektive, një shfaqje për një burrë që këmbëngul të ndjekë të vërtetën kudo që ajo e çon. Por, ngjarjet botërore e ndryshuan kuptimin e kësaj vepre për mua. Kur refugjatët nisën të largoheshin nga *Siria*, fillova të mendoj se sa larg udhëton personazhi i *Edipit*: në fillim, ai është sundimtar i një qyteti. Kur përfundon tragjedia, ai është një i verbuar në mërgim, një njeri i shpërfytyruar, një refugjat. Këto përmbysje janë reale; ato ndodhin çdo ditë.

Në versionin e *Ickes* e shohim veten duke mbajtur anën e *Edipit*, edhe pasi ai zbulohet si një vrasës dhe një kryes i pavetëdijshëm i incestit. Siç theksoi dramaturgu-regjisor në një ngjarje të mbajtur së fundmi në Muzeun e *Frodit* [Freud Museum] në Londër, një nga pyetjet që shtron vepra është: “A është incesti aq i tmerrshëm, në çdo rrethanë”? Kjo është një pyetje pothuajse e turpshme për kulturën tonë; madje është një pyetje që nuk duhet të shtrohet. Këto drama futen thellë në territore të pathëna dhe të paimagjinueshme. Ato shtrihen në vendet më të errëta të zemrës njerëzore. Dhe, kjo është një nga shumë arsyt pse ende kemi nevojë për to. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



UEFA aprovon fillimin e kurseve për Licencën B Fitness për trajnerë

Një tjetër lajm i mirë për zhvillimin e futbollit dhe edukimin sportiv në vend ka arritur nga UEFA, e cila ka aprovuar fillimin e kurseve për Licencën B Fitness për

trajnerët e futbollit. Kësisoj, për herë të parë në Kosovë në muajin prill do të organizohet kursi i Licencës B Fitness, teksa konkursi për pjesëmarrje do të hapet në mes të muajit

mars. Në këtë kurs do të jenë edhe mentorët nga UEFA, Naomi Datson dhe Chris Barnes. Ky është një tjetër hap i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë së trajnimeve dhe

zhvillimin e trajnerëve të fitnesit, duke kontribuar drejtpërdrejt në përgatitjen e lojtarëve dhe përmirësimin e performancës së tyre në fushë. Ky është një tjetër sukses për

Departamentin e Edukimit në Federatën e Futbollit të Kosovës, i cili ka punuar intensivisht për të ofruar një mundësi të tillë për trajnerët e fitnesit.

Nuhio emërohet ndihmëstrajner në Përfaqësuesen A



PRISHTINË, 27 JANAR - Në vazhden e angazhimit të ish-futbollistëve të Përfaqësueses në role të ndryshme në Federatën e Futbollit të Kosovës, ish-sulmuesi "dardan" i njohur Atdhe Nuhio është emëruar ndihmëstrajner i Përfaqësueses A. "Ky vendim i presidentit Agim Ademi vjen si pjesë e strategjisë së FFK-së për të përfshirë ish-lojtarët e

Kombëtares në strukturat e ekipeve kombëtare dhe për ta përcjellë eksperiencën e tyre te gjeneratat e reja", thuhet në njoftimin e FFK-së. Atdhe Nuhio, me karrierë të suksesshme si futbollist, tashmë ka fituar përvojë edhe si trajner në skuadrën austriake SC Rheindorf Altach. Emërimi i tij në stafin e përzgjedhësit Franco Foda pritet të

sjellë mundësi të reja për zhvillimin e tij dhe për sukseset e Përfaqësueses A. Gjatë javës së kaluar në pozitë të ndihmëstrajnerëve të Përfaqësueses U21 dhe U19 u emëruan Hekuran Kryeziu dhe Anel Rashkaj, derisa Samir Ujkani prej më shumë se një viti ushtron pozitën e zëvendësudrejtorit të Përfaqësueses A.

SHKURT

Matheus Alisson përforcon Gjilanin

Skuadra e Gjilanit ka paraqitur transferimin e ri Matheus Alisson. 22-vjeçari i bashkohet Gjilanit nga FC KEK-u, ku pati një sezonin fantastik. "Sport Club Gjilani komunikon angazhimin e futbollistit brazilian Matheus Alisson. 22-vjeçari, i cili luan në pozitën e sulmuesit të krahut, vjen pas një stinori fantastik te FC KEK-u, derisa më parë ka qenë pjesë e disa klubeve nga vendi i tij i origjinës", thuhet në njoftimin e KEK-ut.

Kosova U17 në Kampionatin Mesdhetar të Hendbollit në Podgoricë

Përfaqësuesja U17 e Kosovës në Hendboll (vajzat) do të marrë pjesë në Kampionatin Mesdhetar që prej 17 deri më 22 shkurt mbahet në Podgoricë të Malit të Zi. Është ky kampionati e 18 mesdhetar, ndërsa paraqiten hendbollistet e lindura në vitin 2008 dhe më të reja. Ndonëse konkurrenca është shumë e fortë, kjo do të jetë një përvojë shumë e rëndësishme për hendbollistet tona të reja. Plot 14 ekipe kombëtare janë paraqitur për Mesdhetarin në Podgoricë. Ndeshjet do të zhvillohen në tri pjesë nga 15 minuta. Pikë fitohen edhe për një pjesë të fituar, pos për ndeshje. Kosova do të garojë në Grupin A, bashkë me Kroacinë, Malin e Zi, Sllovakinë, Tunizinë, Italinë e Turqinë. Në Grupin B janë Serbia, Rumania, Spanja, Algjeria, Greqia, Qipro dhe Sllovenia.

Jayveous Mckinnis, MVP i javës në Superligën e basketbollit

PRIZREN, 27 JANAR - KB Bashkimi po vazhdon në top formë në elitën e basketbollit. Prizrenasit në këtë xhiro fituan ndaj Golden Eagle Yllit, ku edhe kësaj radhe u dallua qendra Jayveous Mckinnis. Ai shkëlqeu me 19 pikë e 20 kërcime, derisa shtoi edhe tri bllokada, duke pasur indeksin 37, apo më të lartin në këtë xhiro, duke u shpallur MVP i

javës. Ndeshje mjaft të mirë tregoi edhe Malcolm Armstead, edhe pse nuk arriti ta ndihmojë skuadrën e Yllit. Armstead ndaj Bashkimit e mbylli ndeshjen me 22 pikë, katër kërcime dhe tri asistime. Bora shënoi fitore të rëndësishme ndaj Vëllaznimit, ku te prishtinasit më i miri ishte Henrik Sirko me 18 pikë, gjashtë kërcime

dhe dy asistime. Trepça u rikthye te fitoret, duke mundur Proton Cable Prizrenin, në takimin e zhvilluar në Mitrovicë, ndërsa më i miri ishte 17 pikë dhe shtatë kërcime. Derbin e kësaj jave e fitoi Sigal Prishtina ndaj Pejës, ku më i miri ishte Rashid Mahalbasiq te bardhekaltrit me 15 pikë, 11 kërcime dhe katër asistime.



Oklahoma triumfon ndaj Portlandit

OKLAHOMA, 27 JANAR - Është zhvilluar vetëm një ndeshje natën e mbrëmshme në elitën e basketbollit amerikan NBA. Basketbollistët e Oklahoma City Thunderit mundën si mysafirë Portland Trail

Blazersin me rezultat 118:108 në ndeshjen e vetme të NBA-s të zhvilluar mbrëmë, falë një tjetër paraqitje fantastike nga Shai Gilgeous-Alexander. Fundori kanadez Shai Gilgeous-Alexander

shkëlqeu me 35 pikë, derisa Jalen Williams shtoi 24 pikë të tjera dhe tetë asistime. Blazers, pavarësisht se treshja Avdijsa-Henderson-Camara shënoi 77 pikë, nuk mundi të bëjë një surprizë ndaj skuadrës më të mirë të

ligës. Me këtë fitore Thunderi arriti rekordin 37-8 dhe është skuadra më e mirë në ligë përpara Clevelandit (36-9), ndërsa Portlandi është vetëm i 13-ti në Perëndim me rezultat 17-29.



Rugova ndan përvojën e fituar në Punëtorinë për JR NBA në Paris

PRISHTINË, 27 JANAR - Granit Rugova, drejtor i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore në Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), ka marrë pjesë në Punëtorinë për JR NBA, që është organizuar në Paris. Punëtorinë është organizuar më 24-25 janar, ku kanë marrë pjesë përfaqësueses nga shumë vende evropiane, derisa Rugova është deleguar nga FBK-ja. Ky aktivitet ka ofruar mundësi për të mësuar, rrjetëzuar dhe për ta përfjetuar basketbollin në një mënyrë unike dhe frymëzuese. "Pjesëmarrja ime në Punëtorinë e JR NBA në Paris na bashkoi me përfaqësues nga vende të ndryshme të Evropës dhe më gjerë, për të diskutuar rreth fuqizimit të ligës JR NBA, veçanërisht në Evropë. Temat kryesore përfshijnë strategjitë për përmirësimin e promovimit në rrjetet sociale, minimizimin e sfidave dhe identifikimin e praktikave më të mira për organizimin sa më efektiv të programit JR NBA", ka thënë



Rugova për uebfaqen e FBK-së. Ai ka ndarë edhe përvojën e fituar nga kjo ngjarje. "Punëtorinë përfshiu prezantime nga ekspertë

të ndryshëm, të cilët ndan qasje të vlefshme për ta zgjeruar ndikimin dhe arritjet e ligës. Gjithashtu, pjesëmarrësit patën privilegjin të ishin të pranishëm në ndeshjen e NBA-s ndërmjet Indiana Pacersit dhe San Antonio Spursit, duke shtuar një përvojë unike dhe frymëzuese në këtë aktivitet", shtoi tutje drejtori i Programeve dhe Projekteve Zhvillimore në FBK. "Gjatë punëtorisë pata mundësinë t'i njoftoj zyrtarët e JR NBA për Evropën dhe të krijoj kontakte me përfaqësues nga vende të ndryshme, duke shkëmbyer ide dhe përvoja që do të kontribuojnë në përmirësimin e nismave të JR NBA në Kosovë dhe më gjerë", ka përfunduar Rugova. Kosova për vitin e tretë radhazi është pjesë e këtij projekti, derisa më herët pjesë e punëtorisë kanë qenë Arben Krasniqi, si drejtor teknik i FBK-së dhe Adriatik Racic, drejtor i përfaqësuesëve të Kosovës dhe zëvendëssekretar i FBK-së.

SHKURT

Rubini refuzon ofertën e Lensit për Dakun

Skuadra e Rubin Kazanit i ka rezistuar ofertës së parë të ekipit nga Franca, Lens, për shërbimet e sulmuesit të Shqipërisë, Mirlind Daku. Mësohet se Lensi ka ofruar 7 milionë euro për transferimin e Dakut këtë muaj, por është refuzuar nga Rubin Kazani. Drejtuesit e ekipit rus po pretendojnë të paktën 12 milionë euro për ta lënë të lirë Dakun, i është i gatshëm të largohet gjatë këtij afati kalimtar. Mbetet të shihet nëse Lensi do të bëjë një ofertë tjetër për Dakun, i cili po kërkohet me ngulm edhe nga Lokomotiva e Moskës. Madje Rubin Kazani ka refuzuar edhe ofertën e Lokomotivës prej 8 milionë eurosh për Dakun dhe është në pritje të ofertave të tjera pasi për sulmuesin 27-vjeçar janë të interesuar edhe Cagliari e Parma. Këtë sezon Daku ka shënuar 9 gola dhe ka bërë 5 asistime për Rubin Kazanin, ekip me të cilin ka kontratë deri në vitin 2026.

Inzaghi: Asllani dhe disa lojtarë nga stoli janë sekret i fitoreve

Interi po zhvillon një tjetër sezon shumë të mirë me Simone Inzaghin, teksa është në garë për titullin kampion me Napolin. Strategu italian është shprehur se të gjithë lojtarët kanë kontribut të vlefshëm, duke kujtuar se edhe falë atyre kanë arritur sukseset. Në mesin e tyre, sipas Inzaghit, është edhe Kristjan Asllani. "Frattesi, Carlos Augusto dhe Asllani janë sekreti ynë. Pa ta nuk do të kishim vendosur në fanellë yllin e dytë. Në ndeshjet që kanë zëvendësuar lojtarët e tjerë nuk është ndier mungesa e titullarëve", ka thënë Inzaghi. Në fitoren 4-0 në fushën e Lecces, Kristjan Asllani u përfshi si zëvendësues, ndërsa në takimet e fundit ka treguar se është një lojtar që mund ta zëvendësojë më së miri Calhanoglu.

De La Fuente rinovon kontratën me Spanjën

Luis De La Fuente do të qëndrojë te Spanja. Rinovimi i kontratës së trajnerit me kombëtaren e njohur do të vijojë shumë shpejt. Tekniku do ta udhëheqë Spanjën përtej Kupës së Botës 2026 që do të mbahet në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Meksikë, me synimin e vetëm, suksesin. Ai ka besimin e plotë të drejtuesve të Federatës, teksa ia doli që të dërgojë përfaqësuesen e njohur në majën e futbollit Evropian. De La Fuente, me gjasë do të firmosë një kontratë të vlefshme deri në vitin 2028. 63-vjeçari ka drejtuar skuadrën në 27 ndeshje, me ekipin që ka marrë mesatarisht 2.63 pikë për ndeshje.

Dybala rinovon kontratën me Romën deri në vitin 2026

Paulo Dybala do të vazhdojë ta veshë fanellën e Romës, pasi është aktivizuar rinovimi automatik i kontratës me klubin verdhekuq. Argentinasi ka arritur numrin e paraqitjeve të nevojshme për ta aktivizuar opsionin dhe kontrata e tij është zgjatuar deri në vitin 2026. Ai do të fitojë 8 milionë në sezon, duke përfshirë bonuset. Njoftimi erdhi nga drejtori sportiv i klubit, Ghisolfi: "Zyrtarisht u bë rinovimi. Jemi shumë të lumtur sepse ai është një lider dhe një figurë e rëndësishme për klubin dhe për tifozët".

Norris: Mendova se mund të shpallesha kampion, këtë vit do të jem më egoist në pistë

BRISTOL, 27 JANAR - Vitin e kaluar piloti britanik i McLarenit, Lando Norris, shpësoi se mund të shpallej kampion bote në Formula 1, por një gjysmë e dytë e mirë e sezonit nuk mjaftoi. Gjithsesi, ai nuk heq dorë nga ëndrra dhe shpreson që ky vit të jetë më i mirë. Madje ai i ka idetë e qarta nga ajo që pret nga vetja dhe skuadra. "Vitin e kaluar titulli ishte i arritshëm. Më duhet të përmirësoj disa gjëra për sezonin e ri. Më duhet të punoj në disa aspekte dhe të kthehem më i fortë. Përveçse dua të fitoj kampionatin e konstruktorëve çdo vit, unë gjithashtu dua të jem egoist dhe të fitoj kampionatin e pilotëve", ka thënë Norris. "Për ta realizuar ëndrrën time, duhet të kesh një ekip të mirë pas teje dhe mendoj se kjo është pikërisht ajo që kam. Vitin e kaluar iu afrova titullit, e



ndieja erën e titullit dhe kisha ndjenjën se mund t'ia dilja mbanë", u shpreh më tej piloti britanik i McLarenit. "Mendoj se si skuadër duam të bëjmë një hap përpara që të mund të fitojmë më lehtë garat që janë të favorshme për ne. Gjatë

pushimeve dimërore ekipi ishte shumë i fokusuar. Gjëja më e lehtë për të bërë ishte të relaksohej, por ishte e kundërta. Në fabrikë ata e kuptuan se ne duam më shumë dhe ata punuan për t'u përmirësuar", ka deklaruar Norrisi.

Flicku pas fitores 7-1: Ishte një ndeshje e jashtëzakonshme

Barcelona ka shkëlqyer ndaj Valencias në La Liga duke fituar me rezultat bindës 7-1. Fitorja mban katalanasit në vendin e tretë, por ky rezultat

jep më shumë besim te lojtarët. Trajneri Hansi Flick ka thënë se Barcelona ka luajtur në mënyrë të përsosur, derisa fitorja do t'i japë besim

për ndeshjet e radhës. "Ne e filluam takimin të fokusuar. Mënyra se si i shënuam këta gola ishte fantastike. Ishte një lojë e mrekullueshme. Të

gjithë ishin shumë të përfshirë në manovër dhe luajtën në mënyrë të përsosur. Unë jam i kënaqur me rezultatin, lojën dhe gjithçka

në këtë ndeshje. Një fitore që na jep besim, pasi në mesjavë kemi një tjetër ndeshje dhe duhet të jemi gjithnjë gati", ka thënë Flicku.

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe të gjitha aktet tjera ligjorë për ndryshim plotësimet e këtij ligji, si dhe bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, shpall:

K O N K U R S

KONKURS PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës:

-Kordinator i mirëmbajtjes

Entiteti: NPL "Tregu" Sh.A

Vendi: Mitrovicë

Afati për aplikim (15) ditë nga data 27.01.2025 deri më 10.02.2025

Përshkrim

NPL "Tregu" Sh.A është ndërmarrje publike lokale në pronësi me 100% të aksioneve të saj nga Komuna e Mitrovicës. Të ardhurat e mëdha të kësaj ndërmarrje gjenerohen nga aktivitetet e hyrje-daljeve të ndërmarrjes. NPL "Tregu" Sh.A është në kërkim të stafit mbështetës-teknik të ndërmarrjes me kualifikim, me integritet të njohurive, përvojë të nevojshme profesionale që do të kujdesen në ndërmarrje në përputhje me parimet e njohura profesionale.

Vendi i punës: Kordinator i mirëmbajtjes

Përgatitja dhe shkathtësitë profesionale:

- ◊ Diplomë e shkollës së mesme
- ◊ Përparësi edukimi - Certifikimi në fushën e Përkatëse.
- ◊ Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip.
- ◊ Të dëshmoj aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë ndërmarrjes.
- ◊ Nivel të lartë të motivimit, vet iniciativë dhe vëmendje në detaje.
- ◊ Nivel të lartë të etikës profesionale.

Përgjegjësitë kryesore janë:

- ◊ Planifikimi dhe organizimi i mirëmbajtjes së hapësirës së tregut.
- ◊ Përcaktimi i prioriteteve për riparime dhe përmirësime.
- ◊ Mbikëqyrja e teknikëve dhe stafit të mirëmbajtjes për të siguruar kryerjen e detyrave me efikasitet.
- ◊ Monitorimi i pajisjeve dhe inventarit.
- ◊ Informimi i menaxhmentit për statusin e projekteve të mirëmbajtjes dhe për çdo vonesë ose problem.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacioni për punë
- CV-ja
- Dëshmia mbi përgaditjen profesionale
- Çertifikata e lindjes (origjinal)
- Letërnjoftimi (kopje)
- Përvoja e punës nga lëmia profesionale(për pozitë që nevojiten)
- Vërtetimi se nuk jeni nën hetime dhe vërtetimi që nuk keni të kaluar kriminale.

Vërejtje: I gjithë dokumentacioni merret në zyrë e NPL "Tregu", rr.Adem Voca, Mitrovicë si dhe duhet të dorëzohet i mbyllur në zarf.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe ftohen për intervistë.

27.01.2025

Musa Preteni

Mitrovicë

Kryeshf Ekzekutiv NPL 'Tregu' SH.A.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Doro-Fix" Sh.p.k Stankoc, Gllgoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për rritjen e kapacitetit të prodhimit në fabrikën e fasadës, ngjyrave dhe llaçrave në Sankoc, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.03.2025 në ora 10:00 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët "Luigj Gurakuqi" fshati Sankoc, komuna e Gllgocit do të organizohet debat publik nga Kompania "Doro-Fix" Sh.p.k Stankoc, Gllgoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Doro-Fix" Sh.p.k Stankoc, Gllgoc për rritjen e kapacitetit të prodhimit në fabrikën e fasadës, ngjyrave dhe llaçrave në Sankoc, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mini Bus Ismet Bala, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330255655.

- Launora Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Dy Dëshmorët".

- Negjdet Gllgjani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Kadri Kusari".

- Nadire Bordoniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Gani Qavderbasha".

- Elvis Kuzhnini B.I. NGA Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810107161.

- Kristjan Margegaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Mimoza Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Ilmi Sadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Pjetër Bogdani".

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Manse Leangu” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812122688 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Manse Leangu” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812122688 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Manse Leangu” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812122688 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ECO SUN” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811875410 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ECO SUN” L.L.C. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811875410 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ECO SUN” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811875410 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Sakt TECH” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811988396 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Sakt TECH” D.O.O. Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811988396 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Sakt TECH” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811988396 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Auto Salon Dreni” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810049149 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.


OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Auto Salon Dreni” D.O.O. Mitrovicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810049149 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Auto Salon Dreni” L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 810049149 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

11 vite pa me te dashurin tone



Mustafë R. Isufi

Ishe dhe do te mbetesh perhere krenaria dhe shtylla kryesore e familjes.
Malli per ty vetem sa vjen dhe shtohet.
Koha kalon por jo edhe dhimbja

Te kujtojne me mall dhe dashuri: bashkeshortja Xhemilja, djemt: Gazmendi, Arbeni, Mentori, vajzat Lavdia dhe Merita.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



